



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA



NDIHMJA JURIDIKE | PRAVNA POMOC
LEGAL AID

RAPORTI VJETOR
2009

KOMISIONI PËR
NDIHMË JURIDIKE

Hartuar për
Kuvendin e Kosovës

Dorëzuar më: 31.03.2010

FJALA HYRËSE E KOMISIONERIT PËR NDIHMË JURIDIKE.....	3
FJALA HYRËSE E KOORDINATORES PËR NDIHMË JURIDIKE	4-5
HISTORIK I SHKURTËR I KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE.....	6-7
FUSHËVEPRIMI DHE AKTIVITETET E KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE.....	7-13
FUSHËVEPRIMI DHE AKTIVITETET E ZYRËS KOORDINUESE PËR NDIHMË JURIDIKE.....	14-24
FUSHËVEPRIMI DHE AKTIVITETET E BYROVE TË QARKUT PËR NDIHMË JURIDIKE.....	24-28
BASHKËPUNIMI I KOMISIONIT ME ODËN E AVOKATËVE TË KOSOVËS.....	28
BASHKËPUNIMI I KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE ME OJQ-TË NË PARTNERITET.....	29
BURIMET FINANCIARE DHE NIVELI I FINANCIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE.....	29-30
MANGËSITË DHE SFIDAT NË SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE.....	30-31
REKOMANDIMET PËR VITIN 2010.....	31-32
ANEKS TABELA STATISTIKORE PËR NDIHMËN JURIDIKE TË OFRUAR GJATË VITIT 2009 (e detajizuar).....	32-39

H y r j e

Komisioni për Ndhimë Juridike, është themeluar me 26 shtator 2007, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/36 si organ i pavarur, përgjegjës për të siguruar ndihmë juridike falas, në lëmit penale, civile dhe administrative për qytetarët e Kosovës, qytetarët e huaj e që përkohësisht ndodhen në Kosovë (parimi i reciprocitetit) dhe personave të tjerë të përcaktuar me ligje ose marrëveshje ndërkombëtare të cilët i plotësojnë kushtet sipas ligjit, për të ju ofruar kjo ndihmë.

Themelimi i këtij organi, i pari i këtij lloji në regjion, dëshmon përkushtimin e shtetit të Kosovës për një të ardhme më të mire, ku sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut radhiten ndër objektivat kryesore.

Ky synim i shtetit të Kosovës manifestohet me përcaktimin e NJ si kategori kushtetuese, në nenin 31 paragrafi 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet: “Ndhimja juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi”. Ndërsa me nenin 142, sigurohet baza ligjore për kontinuitet të NJ si Agjenci e Pavarur.

Në vitin e tretë të funksionimit të KNJ-se, falë ndihmës së UNDP-së, kemi shtuar edhe për pesë, e kështu duke e ngritur në dhjetë, numrin e zyrave të NJ-së në nivel të vendit.

Natyrisht që kapacitetet ekzistuese qofshin ato njerëzore, organizative, ligjore e posaçërisht ato buxhetore, kur merret parasysh niveli i varfërisë dhe klientela potenciale e KNJ-së, nuk janë të dëshiruarat dhe kanë nevojë për rishqyrtime dhe për reforma e ndryshime rrënjësore, posaçërisht me unifikimin e ndihmës juridike të një institucion të vetëm, pra të KNJ-së.

Dhe kjo do të arrihet, me nxjerrjen e Ligjit për Ndhimën Juridike Falas, për të cilin ju jemi tepër mirënjohës për mbështetje, institucioneve relevante, e posaçërisht e juaja të nderuar deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në përmbushjen e mandatit të vet ligjore KNJ, do të bashkëpunoj shumë ngushtë më të gjithë partnerët e vetë vendor dhe ndërkombëtar e posaçërisht me akteret që merren me implementimin e standardit për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës, me synim që KNJ të shndërrohet në një institucion të pavarur modern dhe efektiv, më qellim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe sasisë së shërbimeve, në mënyrë që t’i përgjigjet kompleksitetit dhe rëndësisë së mandatit që i është besuar me ligj.

Raporti vjetor i punës të Komisionit për Ndhmën Juridike / 2009

Objektivi kryesor i këtij raporti është prezantimi dhe pasqyrimi i punës së KNJ-së si dhe informimi i drejtë dhe i plotë i Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, publikut dhe grupeve tjera të interesit të përfshira në sistemin e sektorit të drejtësisë.

Në fund më lejoni të ju siguroi konsideratën dhe përkushtimin më të lartë të gjithë stafit të NJ-së, në përmbushjen e objektivave dhe obligimeve tona, gjithnjë në interesin e atyre qytetarëve, që më se tepërmi ju nevojitet kjo ndihmë, e të tillë fatkeqësisht ka mjaft në vendin tonë.

I nderuari z. Kryetar, e nderuara Kryesi, Deputet të nderuar kam nderin, që më është dhënë rasti që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i paraqes raportin e trete vjetor të punës së KNJ,.

Me respekt,

Sokol Haziri

Komisioner i Ndhmës Juridike

Parathënie

Gjatë vitit 2009, Komisioni për ndihmë juridike i Kosovës ka vazhduar në kontinuitet zhvillimin e aktiviteteve të veta për ofrimin e ndihmës juridike të drejtpërdrejtë, qytetarëve të Republikës së Kosovës me gjendje të vështirë ekonomike, dhe njëkohësisht duke siguruar se ndihma juridike e ofruar është e efektshme, efikase, gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe e qëndrueshme. Në këtë mënyrë qytetarëve që i plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas procedurave standarde të veprimit të Rregullores së UNMIK-ut për ndihmë juridike në Kosovë (2006/36) iu është mundësuar qasja e barabartë në drejtësi.

Në veçanti do të cekja punën e pandalshme për zgjerimin e ndihmës juridike në Kosovë edhe në 5 komunitet të Kosovës pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit mes United Nations Development Programme (UNDP) dhe Komisionit për ndihmë juridike në shtatorin e vitit 2009.

Për më tutje, kemi vazhduar të përkujdesemi që në emër të drejtësisë, për të gjithë nevojtarët e ndihmës juridike në Kosovë të krijohet vetëdija e mbrojtjes së interesave të tyre për shkak të mungesës së mjeteve materiale që ata/ato i kanë me të cilat i mohohet qasja e barabartë në drejtësi, sidomos grupeve të cënueshme që përfshin, të pastrehë, të moshuarit, gratë, fëmijët, personat me paaftësi dhe personat që u përkasin bashkësive joshqiptare në Kosovë, por nuk kufizohet vetëm në personat e varfër¹.

E drejta për qasje në drejtësi, dhe për një gjykim të ndershëm, përfshihen gjerësisht në konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut e tani ato i ka njohur në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Institucionalizimi i sistemit të ndihmës juridike në Kosovë tregon edhe njëherë vullnetin e institucioneve të Kosovës për t'iu bërë të mundur qytetarëve të Kosovës qasjen në drejtësi si dhe ngritjen e nivelit të sundimit të ligjit në Kosovë. Qëllimi afatgjatë i sistemit integruar të ndihmës juridike është të ndihmohet forcimi i shtetit ligjor në Kosovë, përmes ngritjes së kulturës juridike të qytetarëve për shfrytëzimin e rrugës institucionale në zgjidhjen e situatave kontestuese, që bëhet e mundur vetëm përmes qasjes së barabartë të gjithë qytetarëve në shërbimet e ndihmës juridike falas.

Obligimi i shteteve për të siguruar mbështetje ligjore falas për grupet e cënueshme përfshihen edhe në parimet ndërkombëtare të ndryshme sikurse Parimet Bazë të Kombeve të Bashkuara mbi Rolin e Avokatëve dhe Kartën Evropiane të Drejtave Themelore. Për më tutje, Parimet Bazë të KB cekin që qeveritë duhet të ndajnë edhe resurse të mjaftueshme financiare si dhe burime të tjera për të ofruar shërbime ligjore personave në nevojë duke përfshirë edhe shërbimet ligjore të personave të varfër.

Që nga themelimi, Zyra Koordinuese ka vazhduar të punojë në hartimin dhe miratimin e një baze të fortë ligjore nga KNJ dhe me promovimin dhe zbatimin e saj nga ana e Zyrës Koordinuese. Në përputhshmëri me misionin e vet, ndihma juridike ka vazhduar të punon në mënyrë transparente dhe konsultative, me qëllim të përmbushjes së synimeve të veta në procesin e zhvillimit të një sektori të mirëfilltë të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Gjatë vitit 2009, KNJ ka vazhduar tejkalimin e sfidave të shumta për funksionalizimin e plotë të rolit të vet në ngritjen e nivelit të qasjes efektive në drejtësi për qytetarët e Kosovës. Do të cekim hartimin e planit të punës për vitin 2009 i cili nga 14 aktivitete të listuara ka arritur realizimin 90%, hartimi i planit strategjik të zhvillimit të NJ, hartimi dhe miratimi i një organogrami funksional për KNJ (ndërtimi i një strukture të re organizative) si dhe kompletimi e profesionalizimi i personelit të KNJ. Këto çështje mbasin prioritetet e ZK-së edhe në vitin 2010.

Të gjitha këto aktivitete të përmbledhura në vitin 2009 janë kryer me qëllim të ngritjes sa më profesionale të personelit të KNJ-së, ofrimin sa më të mirë dhe më profesional të shërbimeve të KNJ-së, me synim që ky institucion të shndërrohet në një institucion të pavarur modern dhe efektiv duke iu përgjigjur kompleksitetit dhe rëndësisë së mandatit që i është besuar me ligj.

Gjatë vitit 2010, ZK-ja do të mbetet vigjilente dhe e gatshme të angazhohet në tejkalimin e sfidave të shumta. Në të ardhmen e afërt do të fokusohet në hartimin dhe miratimin e një ligji të ri për ndihmë juridike në Kosovë, ligjin i cili do të hartohet nga institucionet e Kosovës për një ndryshim të theksuar të Rregullores 2006/36 të UNMIK-ut mbi ndihmë juridike e cila ende udhëheq punën e KNJ-së.

Duke marrë parasysh nivelin e lartë të varfërisë në vendin tonë do të vazhdojmë të angazhohemi maksimalisht për përkrahje më të madhe institucionale në veçanti përkrahja financiare në përputhje me Planin afatmesëm tre-vjeçar të shpenzimeve të hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave të Kosovës. Gjetja e mënyrave alternative të përkrahjes nga ana e donatorëve potencial do të jetë mundësi që ZK do të hulumton pandërprerë. Të gjitha këto aktivitete do të vazhdojnë rrugëtimin tonë edhe në vitin 2010 në mënyrë që ky institucion të mban vendin e merituar në strukturën institucionale të Republikës së Kosovës.

Drita Rexhepi
Koordinatorë e Ndhimës Juridike

I. HISTORIKU I SHKURTËR I NDIHMËS JURIDIKE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila hyri në fuqi me 15 qershor 2008, mbron parimin e të drejtës së qytetarëve për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (Neni 31). Kushtetuta e Kosovës ri-konfirmon që *‘ndihma juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi’* (Neni 31). Për me tutje, Kushtetuta parasheh se sistemi i ndihmës juridike bëhet në pajtim me ligjin në fuqi dhe veçanërisht me Kornizën e Konventës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe ajo do të ofrohet në gjuhët e kërkuara.

Baza ligjore e fushëveprimit të Komisionit për Ndhmë Juridike mbetet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/36 për Ndhmë Juridike (për më tutje Rregullorja 2006/36). Në përputhje me Rregulloren 2006/36 më 26 shtator 2007 filloi funksionalizimi i Komisionit të Kosovës për Ndhmë Juridike (KNJ) pas bartjes së kompetencave nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut. Koncepti i ndihmës juridike ishte përkrahur nga viti 2001-2005 si projekt i Agjencionit Evropian për Rindërtim i quajtur Projekti i “Ndhmës juridike falas në çështje civile dhe administrative,” implementuar nga Oda e Avokatëve të Kosovës në bashkëpunim me Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ) vendore. Qeveria e Kosovës ndau nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, një buxhet modest por të rëndësishëm për funksionalizimin dhe institucionalizimin e projektit të ndihmës juridike pas hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/36.

Insitucionalizimi i ndihmës juridike në Kosovë me krijimin e Komisionit për Ndhmë Juridike, i pari i këtij lloji në regjionin e Evropës Jug-Lindore ofron dhe siguron qasjen në drejtësi për qytetarët e Kosovës duke konfirmuar gatishmërinë e institucioneve të Kosovës në promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e parimeve të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

KNJ ushtron veprimtarinë si organ i pavarur, përgjegjës për sigurimin e ndihmës juridike falas në lëmitë penale, civile dhe administrative për të gjithë qytetarët e Kosovës, qytetarët e huaj që përkohësisht ndodhen në Kosovë në bazë të parimit të reciprocitetit si dhe për personat e tjerë të përcaktuar me ligje ose marrëveshje ndërkombëtare. Pavarësia në ushtrimin e funksionit të vet KNJ i garantohet me Rregulloren 2006/36 ku në mënyrë specifike ceket se ‘Komisioni i kryen funksionet e tij në mënyrë të pavarur... pa udhëzime apo ndërhyrje nga asnjë person’ (Neni 1.2).

Parimi bazë i veprimtarisë së KNJ-së është ofrimi i ndihmës juridike për të gjithë qytetarët e Kosovës në bazë të parimit të mos-diskriminimit ndaj asnjë personi pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, racore, politike, gjinore apo ndonjë dallim tjetër. Për më tutje, parimi i transparencës si dhe respektimi i plotë i ligjit dhe Konventave Ndërkombëtare e përkufizojnë më detajisht qasjen e ofrimit të ndihmës juridike në Kosovë.

Duhet cekur se KNJ ofron qasjen në drejtësi dhe ndihmë juridike falas kategorive të qytetarëve të cilët kanë mungesë të mjeteve materiale si dhe grupeve më të rrezikuara dhe më të ndjeshme të shoqërisë duke përfshirë të pastrehët, të moshuarit, gratë, fëmijët, personat me paaftësi dhe personat që u përkasin bashkësive joshqiptare në Kosovë, por nuk kufizohet vetëm në personat e varfër.ⁱⁱ Këto kategori nuk kufizohen vetëm në personat e varfër por përfshijnë edhe personat e arrestuar ose të paraburgosur nga ana e policisë pavarësisht gjendjes së tyre materiale, si dhe për të gjitha rastet kur parashihet mbrojtja e detyrueshme në bazë të Kodit Penal të Kosovës (nenet 73 dhe 74).ⁱⁱⁱ

II. FUSHËVEPRIMI DHE AKTIVITETET E KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE

Në përputhshmëri me Rregulloren 2006/36 për ndihmë juridike në Kosovë^{iv} është paraparë funksionalizimi i ndihmës juridike në Kosovë. Rregullorja në fjalë parasheh tre institucionet kyçe të ndihmës juridike në Kosovë: Komisioni për ndihmë juridike; Zyra Koordinuese për ndihmë juridike dhe Byrotë e qarkut për ndihmë juridike

Rregullorja 2006/36 gjithashtu parasheh edhe bashkëpunimin e KNJ-së me Odën e Avokatëve të Kosovës për të përcaktuar dhe siguruar përfaqësimin e drejtë të grupeve të cënueshme, për të përcaktuar përfituesit dhe ofruesit e ndihmës juridike që të sigurohet cilësia e duhur e shërbimeve ligjore të ofruara në sistemin e ndihmës juridike (Kapitulli 2 i Rregullores 2006/36).

a) MANDATI I KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE

Drejtimi dhe mbikëqyrja e sistemit të ndihmës juridike është në mandatin e Komisionit për ndihmë juridike i cili duhet të siguron që ofrimi i ndihmës juridike në Kosovë është i efektshëm, efikas, gjithëpërfshirës, fleksibil dhe i qëndrueshëm. Komisioni për Ndhmë Juridike ka për detyrë të sigurojë qasje të plotë në drejtësi për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe të sigurojë që Republika e Kosovës të përmbush standardet për qasje në drejtësi, siç është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe konventat ndërkombëtare drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë.

Në mënyrë specifike, sistemi i ndihmës juridike në Kosovë mundëson qasje në drejtësi përmes sigurimit të:

- a) Ofritit të informative dhe këshillave qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre ligjore dhe mjeteve juridike;

- b) Përfaqësimit të palëve pranë gjykatave dhe organeve administrative, duke përfshirë ekzekutimin e aktvendimeve dhe vendimeve ose ushtrimin e ankesave ndaj atyre aktvendimeve dhe vendimeve ;
- c) Ndhmës lidhur me përpilimin e dokumenteve juridike edhe ne procedurat ligjore, duke përfshirë ndërmjetësimin, arbitrazhin dhe mënyrat alternative në zgjidhjen e kontesteve;
- d) Edukimit të opinionit lidhur me çështjet juridike ;
- e) Këshillimit të Qeverisë mbi mënyrat e thjeshtësimit të procedurave ligjore;
- f) Lirimit nga pagesat e kompensimeve në të holla dhe shpenzimeve të krijuara me rastin e realizimit të të drejtave ligjore dhe mjeteve juridike, të parapara me ligj; dhe
- g) Ofrimit të formave të tjera të ndihmës, të cilat nevojiten për realizimin efektiv të të drejtave dhe mjeteve juridike, duke përfshirë edhe të drejtën për ndihmën juridike.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e KNJ-së përfshijnë:

- a) Zhvillimin e politikave, procedurave dhe programeve për ofrimin e ndihmës juridike dhe përdorimin e shfrytëzimit të fondeve të donatorëve;
- b) Caktimin e përparësive për çështjet për të cilat ofrohet ndihma juridike me kufizimet duke marrë parasysh resurset në dispozicion;
- c) Mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të KNJ-së;
- d) Sigurimin e baraspeshës të financimit dhe të shpenzimeve të KNJ-së;
- e) Kërkimin e dhuruesve dhe ofruesve të mundshëm si dhe miratimin e kontratave lidhur me ofrimin e ndihmës juridike;
- f) Mbikëqyrjen e menaxhimit, shpenzimet dhe llogaritjen e buxhetit të Komisionit dhe pagesave nga Zyra Koordinuese e NJ;
- g) Bashkërendimin e sistemit të ndihmës juridike;
- h) Sigurimin që ndihmë juridike të është në dispozicion për të gjitha grupet e cënueshme në përputhje me ligjin;
- i) Shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve etike gjatë ofrimit të ndihmës juridike;
- j) Vëzhgimin dhe vlerësimin e cilësisë dhe efektshmërisë së ndihmës juridike;
- k) Përgatitjen e buxhetit të ndihmës juridike dhe të drejtuarit e KNJ-së kah donatorët, Qeveria dhe autoritetet buxhetore për mbështetje shtesë për sistemin e ndihmës juridike në Kosovë;
- l) Themelimin e mekanizmave për shqyrtimin e vendimeve për sigurimin apo mohimin e ndihmës juridike;
- m) Zgjedhjen dhe mbikëqyrjen e nëpunësve të Komisionit;
- n) Ndërmarrjen, nxitjen dhe bashkërendimin e hulumtimit të pavarur mbi ndihmën juridike;
- o) Krijimin dhe mirëmbajtjen e klinikave të ndihmës juridike dhe agjencive të tjera të përshtatshme për ofrimin e ndihmës juridike;
- p) Mbajtjen e një regjistri për ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave lidhur me funksionet e Komisionit;
- q) Kontraktimin për mallra dhe shërbime lidhur me funksionet e Komisionit;

- r) Pezullimin apo largimin e avokatëve nga lista e shërbimit të cilët nuk i përmbushin kërkesat e Rregullores 2006/36;
- s) Miratimin e akteve nënligjore për procedurën e ofrimit të ndihmës juridike.^v

KNJ ka vazhduar të punon dhe vepron edhe në vitin 2009 në bazë të Rregullores 2006/36 të UNMIK-ut për ndihmë juridike dhe në bazë të legjislacionit sekondar të hartuar dhe aprovuar nga ana e KNJ-së në dhjetor të vitit 2007, si në vijim:

- 1. Doracaku për ndihmë juridike**, doracak për zyrtarët e byrove të qarkut për ndihmë juridike (BQNJ), në zbatimin e sistemit të ndihmës juridike, përcaktimin e rregullave dhe praktikës ligjore në punën e tyre të përditshme.
- 2. Kodi i etikës** për stafin e KNJ-së dhe personelin e NJ-së, i cili përcakton standardet më të larta të mirësjelljes së personelit, duke përfshirë integritetin, paanshmërinë dhe objektivitetin.
- 3. Formularët** (aplikacionet) për kërkuesit e ndihmës juridike, për avokatë, ekspertë, të modifikuar dhe aprovuar edhe në vitin 2009.

b) PËRBËRJA E KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE

Komisioni për Ndhmë Juridike përbëhet nga Komisioneri dhe 8 zëvendës të cilët janë profesionistë në sistemin e drejtësisë dhe kanë njohuri përkatëse për ndihmën juridike. Për më tepër zyrtarët e KNJ-së duhet që në punën e Komisionit të sjellin njohuri përkatëse dhe shkathtësi të vlefshme të rajoneve prej nga vijnë. Zyrtarët profesionistë të KNJ-së nuk duhet të pranojnë udhëzime nga institucionet që i kanë kandiduar apo që i kanë emëruar por duhet të përfaqësojnë drejtpërsëdrejti interesat e përfituesve apo ofruesve të ndihmës juridike. Për shërbimin e tyre ata/ato marrin honorar si dhe kompensohen për shpenzimet që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me shërbimin e tyre në emër të Komisionit.

Emërimi i zyrtarëve të KNJ-së shkon si në vijim: Komisioneri emërohet nga Kryeministri, pas konsultimit me Ministrin e Drejtësisë, me Komisionin e Kuvendit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, me kryetarin e Gjykatës Supreme, me Odën e Avokatëve të Kosovës dhe me organizatat joqeveritare që zhvillojnë aktivitete nga fushat me rëndësi për funksionimin e sistemit të ndihmës juridike. Zëvendëskomisionerët emërohen nga Kryeministri, pas nominimit nga institucionet e përcaktuara me nenin 4 alineja 4 të Rregullores 2006/36.

KNJ edhe gjatë vitit 2009 ka vazhduar të funksionoj me përbërjen e vet të rregullt, përpos që në gjashtë-mujorin e dytë të vitit 2009 dy zyrtar të rregullt të KNJ-së Znj. Gjylieta Mushkolaj dhe Z. Altay Suroy kanë dhënë dorëheqje të parevokueshme për shkak të emërimit të tyre në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Në vend të tyre janë emëruar dy anëtar të rinj. Me nominimin e Rrjetit të Grave të Kosovës (OJQ) është emëruar në muajin tetor 2009 Znj. Shukrije Gashi dhe me nominimin e Ministrisë së Drejtësisë është emëruar në muajin

dhjetor 2009 Znj. Arta Kelmendi. Të dy anëtarët janë emëruar në funksionin e zëvendës-komisionereve me mandat të rregullt 4 vjeçar.

Në vijim paraqesim listën e përbërjes së Komisionit deri më datën 31.12.2009:

Komisioni përbëhet nga një komisioner dhe tetë (8) zëvendës, të cilët janë profesionistë të kualifikuar që kanë njohuri për ndihmën juridike dhe sistemin e drejtësisë apo të cilët sjellin njohuri përkatëse dhe shkathtësi të vlefshme të rajoneve nga vijnë në punën e Komisionit.

Zëvendësit emërohen nga Kryeministri nga kandidatët e paraqitur nga palët e interesuara të përfshira në sistemin e ndihmës juridike si më poshtë

- a) Një (1) nga tre (3) kandidatët të paraqitur nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
- b) Një (1) nga tre (3) kandidatët të paraqitur nga Ministria e Drejtësisë;
- c) Një (1) nga tre (3) kandidatët të paraqitur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- d) Një (1) nga tre (3) kandidatët të paraqitur nga kryetari i Gjykatës Supreme;
- e) Dy (2) nga tre (3) kandidatët të paraqitur nga Shoqata e Rrjetit të Grave të Kosovës, e regjistruar si subjekt ligjor në regjistrin e OJQ-ve në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe
- f) Dy (2) nga tre (3) kandidatët të paraqitur nga Ministria për Kthim dhe Komunitete^{vi}

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Institucioni	Mandati
1.	Sokol Haziri	Komisioner	Ministria e Drejtësisë	4 vjet
2.	Besa Krajku	Zëvendëse	Gjykata Supreme	3 vjet
3.	Abdurrahim Broqi	Zëvendës	Ministria për Kthim dhe Minoritete	3 vjet
4.	Sladjana Vasić	Zëvendëse	Ministria për Kthim dhe Minoritete	5 vjet
5.	Fadil Racaj	Zëvendës	Ministria për Punë dh Mirëq. Soc.	3 vjet
6.	Isa Mustafa	Zëvendës	Oda e Avokatëve të Kosovës	3 vjet
7.	Shukrije Gashi	Zëvendëse	Rrjeti i Grave të Kosovës	4 vjet
8.	Virgjina Dumnica	Zëvendëse	Rrjeti i Grave të Kosovës	3 vjet
9.	Arta Kelmendi	Zëvendëse	Ministria e Drejtësisë	4 vjet

c) **AKTIVITETET E KOMISIONIT**

Ndër të arriturat më të rëndësishme të KNJ-së gjatë vitit 2009, duhet të ceket nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) midis United Nations Development Programme (UNDP) dhe KNJ-së, të datës 10 shtator 2009 me të cilin MM janë përcaktuar obligimet dhe të drejtat e palëve nënshkruese në projektin e ashtuquajtur “Qasja në Drejtësi” me qëllim të hapjes së zyrave për

ndihmë juridike në Komunitet e Graçanicës, pjesës veriore të Mitrovicës, Dragash, Ferizaj dhe Gjakovë. Këto zyre të reja janë një adresë e re dhe do të ofrojnë shtrirje më të gjerë gjeografike të ndihmës juridike falas në Kosovë. Duhet gjithashtu të ceket edhe bashkëpunimi jashtëzakonisht i mirë i KNJ me Kryetarët e Komunave të Gjakovës, Dragashit, Ferizajit dhe në pjesën veriore të Mitrovicës të cilët kanë ofruar zyret falas për hapjen e ndihmës juridike në komunitet përkatese. Vetëm në komunitet e Graçanicës vazhdohet të paguhet qiraja nga projekti në fjalë.

Për zbatimin e mëtutjeshëm të projektit pra hapjen e zyreve të reja të ndihmës juridike në komunitet e lartpërmendura KNJ ka vendosur që të shpallet konkursi për të punësuarit për 5 zyret në Graçanicë, pjesën veriore të Mitrovicës, Dragash, Ferizaj dhe Gjakovë dhe me fillimin e procedurave të prokurimit të bëhet funksionalizimi i zyrave përkatese. Për shkak të vështirësive në funksionalizimin e zyrës së mbështetur nga UNDP në Pjesën e Mitrovicës Veriore në dhjetor të vitit 2009, hapja e saj është shtyrë për vitin 2010.

Gjatë vitit 2009 KNJ ka hapur zyre në 5 komunitet e lartpërmendura Gjithashtu është përfunduar edhe rekrutimi i personelit për këto zyre që numërojnë në total 15 vetë. Me hapjen e zyrave të reja numri i personelit i KNJ ka arrit 42 vetë.

Vlen të ri-cektohet fakti i ngritur si shqetësim në Raportin Vjetor 2008 të KNJ për Kuvendin e Kosovës, se problemet e trashëguara nga koha e udhëheqjes së sistemit të ndihmës juridike nga ana e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut mbesin evidente. Në veçanti UNMIK-u ka dështuar në harmonizimin e legjislacionit penal, përkatesisht të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës me Rregulloren 2006/36 prej nga e nxjerr fushëveprimin KNJ. Në përputhshmëri me problemin e identifikuar, KNJ ka vazhduar lobimin për hartimin e ligjit të ri për ndihmë juridike falas, si kornizë e re ligjore dhe institucionale në sistemin e integritit të ndihmës juridike në Kosovë. Është arritur që në agjendën e vitit 2010 të futet hartimi i Ligjit për ndihmën juridike falas nën përkrahjen e Ministrisë së Drejtësisë.

Në përputhshmëri me mandatin e KNJ për edukimin dhe ngritjen e vetëdijes së publikut për sistemin e ndihmës juridike në Kosovë dhe shërbimet e ofruara nga ana e KNJ, janë formuar 2 klinika juridike në komunitet e Kamenicës dhe Vitisë. Është iniciuar hapja edhe e katër klinikave në regjionin e Pejës, por për shkak të mungesës së mjeteve motorike, kjo tentativë ka mbetur e porealizuar. Është në procedurë e sipër hapja e klinikës juridike në pjesën veriore të Mitrovicës.

Vlen të ceket që gjatë vitit 2009 janë përcaktuar përparësitë lidhur me llojet e çështjeve, për të cilat do të ofrohet ndihma juridike, mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve dhe udhëzimeve të dhëna nga Komisioni.

d) FUNKSIONIMI I KOMITETEVE TË KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE

Në përputhje me Rregulloren 2006/36,^{vii} Komisioni për ndihmë juridike ka themeluar komitetet përkatëse të përbërë nga anëtarët e Komisionit, të cilëve u delegohen përgjegjësi të veçanta të Komisionit, duke përfshirë buxhetin dhe financat, cilësinë e kontrollit, ankesat, burimet njerëzore, tërheqjen e kontributeve nga donatorët dhe edukimin juridik publik.

Gjatë vitit 2009 në kuadër të KNJ-së kanë vazhduar të funksionojnë 6 komitete:

1. Komiteti për Burime Njerëzore (Fadil Racaj-Kryetar; Arta Kelmendi-anëtare; Abdurrahim Broqi-anëtarë)
2. Komiteti për Buxhet dhe Financa (Abdurrahim Broqi-Kryetarë; Slađana Vasić-anëtare; Shukrije Gashi-Anëtarë)
3. Komiteti për mbledhjen e Kontributeve nga Donatorët (Virgjinë Dumnica-Kryetare; Slađana Vasić-anëtare; Shukrije Gashi-Anëtarë)
4. Komiteti për Ankesa (Isa Mustafa- Kryetar; Besa Krajku-Anëtare; Arta Kelmendi-anëtare)
5. Komiteti për Kontrollin e Cilësisë; (Isa Mustafa-Kryetar; Besa Krajku-Anëtarë; Arta Kelmendi-anëtare)
6. Komiteti për Edukim Juridik Publik.(Shukrije Gashi-Kryetarë; Besa Krajku-Anëtarë; Arta Kelmendi-anëtare)

Për më tutje, KNJ ka themeluar edhe grupe punuese ad hoc për detajizimin e fushëveprimit dhe ushtrimin të përgjegjësive të KNJ-së. Për shembull është themeluar grupi punues për bashkëpunim me OJQ-të i cili ka miratuar edhe kriteret për partneritet me OJQ-të dhe ka përcaktuar shumën e buxhetit për partneritet me OJQ-të për ofrim të ndihmës juridike. Për realizimin e projektit të partneritetit me OJQ-të është themeluar edhe Komisioni për hapjen e ofertave për partneritet me OJQ-të. Rrjedhimisht pas shpalljes së ftesës nga ana e KNJ-së është ndarë shuma për ofrimin e ndihmës juridike për 2 OJQ lokale (shih pjesën Bashkëpunimi me OJQ-të) duke e shtrirë edhe më tej fushëveprimin e zyrave të ndihmës juridike në Kosovë. KNJ gjithashtu ka themeluar edhe Komisionin disiplinor të ndihmës juridike.

Aktivitetet e Komiteteve:

Komiteti për Burime Njerëzore është njëri prej komiteteve i cili fushëveprimin e vet e zhvillon në kuadër të Komisionit për Ndhmë Juridike në përputhje të plotë me dispozitat e Rregullores Nr. 2006/36.

Komiteti i Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2009, gjithsej ka mbajtur pesë takime, në të cilat janë shqyrtuar çështje me interes për zhvillimin dhe avancimin e sistemit gjithëpërfshirës të Ndhmës Juridike. Ndër çështjet më të rëndësishme, të cilat janë shqyrtuar dhe rekomanduar në takimet e këtij Komiteti gjatë vitit 2010 kanë qenë: a) diskutim mbi kapacitetet administrative në Zyrën Koordinuese të Ndhmës Juridike dhe në Byrotë e Qarkut për Ndhmë Juridike; b) Shqyrtimi i dokumentacionit të aplikuesve për pozitat e shpallura në Zyrën Koordinuese të

Ndhimës Juridike dhe Byrotë e Qarkut; c) Ofrimi i asistencës teknike lidhur me zgjedhjen dhe rekrutimin e personelit në Zyrën Koordinuese dhe Byrotë e Qarkut të Ndhimës Juridike;

Komiteti për Buxhet dhe Financa është një nga komitetet i cili gjithashtu fushëveprimin e vetë e zhvillon në për të përkrahur punën e Komisionit të Ndhimës Juridike në përputhje me Rregulloren 2006/36. Gjatë vitit 2009 Komiteti në fjalë ka vepruar në përputhshmëri të plotë me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ndër çështjet më të rëndësishme, të cilat janë shqyrtuar dhe rekomanduar në takimet e këtij Komiteti gjatë vitit 2010 kanë qenë: a) Planifikimi dhe dorëzimi i planit vjetor i nevojave buxhetore të ndihmës juridike; b) Planifikimi i zotimit të mjeteve sipas prioriteteve të identifikuara për ndihmën juridike; c) Përgatitja e kërkesës për ndarjen plotësuese të mjeteve gjatë rishikimit të buxhetit të konsoliduar të Republikës së Kosovës; d) Planifikimi i ekzekutimit të kërkesave dhe detyrimeve; e) Planifikimi i pagesave të kontraktuara f) Raporti mujor i shpenzimeve, raportet tre mujore të shpenzimeve dhe raporti vjetor i shpenzimeve.

Komiteti për kontributet e donatoreve së bashku me ZK të Komisionit të Ndhimës Juridike ka realizuar shumë aktivitete në fushën e bashkëpunimit me donatorët e ndryshëm që veprojnë në Kosovë. Gjatë vitit 2009 fal angazhimeve të shumta të Komitetit në fjalë dhe ZK, buxhetit të KNJ-së i është shtuar buxheti me një shumë të konsiderueshme të mjeteve për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve juridike profesionale në ofrimin e ndihmës juridike falas. .

Në mes tjerash veçojmë takimet për realizimin e projekteve të dhëna më poshtë: a) Në bashkëpunim me UNDP-në janë siguruar mjetet për hapjen e 5 zyrave shtesë, kështu që byrove ekzistuese të qarkut të i'u shtohen edhe zyret në Gjakovë, Ferizaj, Dragash, Graçanicë dhe Pjesën Veriore të Mitrovicës; b) Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë me projektin e ashtuquajtur 'Human dynamics' për mbështetjen e mëtutjeshme për institucionet e drejtësisë në Kosovë dhe ofrimin e mbështetjes në tre komponentë: 1. Dizajnimi i ueb faqes; 2. Dizajnimi i data bazës dhe 3. Trajnime të personelit të KNJ (e përcaktuar); c) Projekti i financuar nga USAID i ashtuquajtur NSCS në ofrimin e trajnimeve të personelit të KNJ në shkrimin ligjor. Me anë të vetëdijesimit nga ana e Komitetit në fjalë është ngrit edhe niveli i interesimit dhe vetëdijes së donatorëve për rëndësinë e përkrahjes së KNJ-së dhe sistemit të ndihmës juridike në Kosovë.

Aktivitetet e tjera të KNJ-së:

Në mes aktiviteteve të shumta KNJ do të veçonte Marrëveshjen e Mirëkuptimit me American Bar Association Rule of Law Initiative (ABA ROL-i) dhe Fakultetin Juridik, për mësimin praktik të studentëve-absolvent të dalluar. Në atë drejtim KNJ-ja, për avokatët e angazhuar nga ABA ROL-i, ka referuar 4 raste; dy në lëmine civile e dy në lëmine penale.

Në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e veta KNJ ka udhëzuar Koordinatorin e ndihmës juridike për vlerësimin e punës për të gjithë të punësuarit në ndihmën juridike deri në fund të vitit 2009. Në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2009, është vendosur që për të gjithë të punësuarit në ndihmë juridike të i vazhdohen kontratat e punës, në periudhën 3 vjeçare pas vlerësimit të suksesshëm të realizuar nga Zyra Koordinuese. Në përgjithësi mund të konkludohet se veprimtaria e komiteteve ka qenë në nivel të përgjegjësisë dhe detyrave të parapara.

Komisioni për Ndhmë Juridike e ka për obligim ligjor të mbajë, së paku, nga një mbledhje në muaj por gjatë vitit 2009 ka mbajtur **22** takime prej të cilave 4 nuk janë mbajtur për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm. Në vitin 2009, prej 18 takimeve janë nxjerrë **80** vendime.

III. AKTIVITETET E ZYRËS KOORDINUESE PËR NDIHMË JURIDIKE

Zyra Koordinuese e ndihmës juridike (ZK) ka rolin e sekretariatit të Komisionit për ndihmë juridike dhe është përgjegjëse për administrimin e sistemit të ndihmës juridike dhe mbikëqyrjen e Byrove të qarkut për ndihmë juridike (BQNJ). Nën drejtimin e Koordinatorit për ndihmë juridike, ZK shërben në rolin sekretar në Komision dhe është përgjegjëse për funksionimin e duhur të ZK-së, për mbikëqyrjen e punës për të gjithë nëpunësit e Komisionit dhe kryerjen e punëve në kuadër të fushëveprimit të KNJ-së në përputhshmëri me Rregulloren 2006/36.^{viii}

Zyra Koordinuese (ZK) gjatë vitit 2009 ka vazhduar të kryejë të gjitha punët përgjegjëse në çështjet operative ditore për ofrimin kualitativ dhe profesional të shërbimeve të ndihmës juridike, administrimin e sistemit të ndihmës juridike dhe mbikëqyrjen e byrove

të qarkut për ndihmë juridike (BQNJ). Gjithashtu ZK ka vazhduar të menaxhojë dhe mbikëqyrë punët e të gjithë të punësuarve pranë institucionit të ndihmës juridike. ZK çdo muaj ka mbajtur takimet e rregullta me përfaqësuesit e BQNJ-ve për sforcimin e komunikimit dhe referimit efikas të rasteve dhe ka vizituar rregullisht BQNJ-të. Për më tutje, ZK vazhdimisht i ka ofruar përkrahje administrative funksionimit të rregullt të takimeve të Komisionit për ndihmë juridike dhe njëkohësisht ka zbatuar të gjitha vendimet e marra nga KNJ.

Lidhur me funksionalizimin e zyrave të reja nga projekti ‘Qasja në drejtësi’ me përkrahjen e donatorit UNDP, ZK ka menaxhuar të gjithë procedurat e prokurimit, të rekrutimit të personelit, përgatitjes dhe identifikimit të zyrave potenciale, hapjes së zyrave të reja, etj. Në sforcimin e mëtutjeshëm të sistemit të ndihmës juridike në Kosovë, ZK ka kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme për hyrjen në partneritet me OJQ-të për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike. Në këtë drejtim, ZK ka përcaktuar kushtet e shpalljes së konkursit për partneritet me

OJQ, ka përgatitur dokumentacionin relevant për konkurruesit, dhe ka formuar panelin e hapjes së ofertave dhe panelin e vlerësimit të ofertave me ndihmën e zyrtarëve të KNJ. Në shtrirjen e ndihmës juridike në vitin 2009, ZK ka arritur edhe nënshkrimin e marrëveshjes për hyrje në partneritet me dy OJQ. Është nënshkruar marrëveshja me OJQ ‘Norma’ për hapjen e zyrës për ndihmë juridike në Podujevë dhe me ‘Shoqatën e Gruas Gjakovë’ për zyrën e ndihmës juridike në Gjakovë.

Në veçanti, ZK gjatë vitit 2009 ka hartuar edhe planin e punës për ZK me identifikimin e 15 aktiviteteve më prioritare për operacionalizim nga ana e ZK-së. Nga 15 aktivitete të listuara vetëm 2 aktivitete nuk janë realizuar në kohën e paraparë dhe mbetet për vitin 2010 implementimi i tyre.

Një përmbledhje e shkurtë në formë tabelare është paraqitur mbi planin e punës 2009 dhe realizimin e atij plani:

Nr.	Aktiviteti/Qëllimi	Realizimi	Rezultati
1.	Një prej organizatorëve të Ditës së Drejtësisë	√	1. Punësoria për dhënien e këshillave juridike qytetarëve. 2. Koordinatorja në panel për diskutimin publik me qytetarët
2.	Propozimi i hartimi i Ligjit për Ndhimë Juridike Falas	√	Përfshirja e Projekt-Ligjit për ndihmë Juridike Falas në Strategjinë Legjislative të Qeverisë
3.	Të mbulohen zonat gjeografike ose grupet e caktuara, për ofrimin e ndihmës juridike nëpërmjet partneritetit me OJQ-të	√	KNJ ka hyrë në partneritet me dy OJQ
4.	Bashkëpunimi me Odën e Avokatëve të jetë i rregullt	√	ZK mban takime të rregullta me OAK në përputhshmëri me Marrëveshjen e Mirëkuptimit për bashkëpunim të vitit 2008
5.	Hartimi i organogramit të ri për KNJ	√	Hartuar dhe miratuar nga KNJ
6.	Fushatë gjithëpërfshirëse për	√	Realizimi i spotit

	edukimin ligjor publik		në 3 TV kanale në gjuhë.
7.	Ngritja profesionale me trajnimin e personelit të ndihmës juridike	√	Trajnimet kanë qenë të vazhdueshme
8.	Njohja institucionale e KNJ-së me vendosjen në funksion ueb faqen zyrtare	√	Është dizajnuar ueb faqja dhe vu në funksion
9.	Arkivimi statistikor i lëndëve të KNJ nëpërmjet bazës së shënimeve	√	Është dizajnuar baza e shënimeve dhe ka filluar arkivimi i lëndëve.
10.	Rritja e numrit të përfituesve të ndihmës juridike me hapjen e zyrave të reja	√	Me anë të projektit 'Qasja në drejtësi' financuar nga UNDP janë hapur 5 zyre
11.	Me anë të formimit të klinikave juridike të afrohem personave në nevojë për ndihmë juridike	√	Hapja e 2 klinikave dhe
12.	Mësimi praktik për studentët e Fakultetit juridik	√	Janë realizuar programe studentore me Fakultetin juridik
13.	Aftësimi i praktikantëve për dhënien e provimit të jurisprudencës	√	Projekt-propozimi është hartuar dhe dorëzuar për përkrahje tek Komision Evropian
14.	Bartja e buxhetit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në buxhetin e Komisionit për ndihmë juridike në lëmit penale	Pritet realizimi gjatë vitit 2010	Përkundër përpjekjeve të KNJ nuk është realizuar
15.	Publikimi i Buletinit me qëllim të informimit të opinionit publik	Pritet realizimi gjatë vitit	Për shkaqe teknike është shtyrë realizimi

√ - Realizuar

Aktivitet e veçanta:

1. ZK në disa raste ka qenë një prej subjekteve relevant në aktivitete institucionalisht të organizuara. Një nga kryesorëve ka qenë Dita e Drejtësisë. ZK për atë ditë ka organizua punëtori, në bashkëpunim me

avokatët, në të cilën, qytetarëve n mënyrën direkte u është ofruar ndihma juridike. Gjithashtu Koordinatorja ka qenë në panel me Kryetarin e Gjykatës Supreme, Ombudspersonin, Drejtorin e Institutit të Drejtësisë së Kosovës, Kryetarin e OAK-së, Kryetarin e Shoqatës së Gjiqtarëve, Dekanin e Fakultetit Juridik etj. të cilit në diskutimin publik janë ballafaquar me shumë pyetje të qytetarëve.

2. ZK ka realizuar takime të rregullta me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë lidhur me themelimin e Pallatit të Drejtësisë në Kosovë. Në koordinim me KE, ZK ka rekomanduar qe institucioni i Komisionit për ndihmë juridike i Kosovës të jetë i sistemuar ne Pallatin e Drejtësisë. Për më tepër, ZK ka ofruar edhe organogramin e ri të hartuar dhe miratuar nga KNJ për përfshirjen e institucionit të KNJ në kuadër të Pallatit të Drejtësisë.
3. ZK ka përpiluar dhe konkurruar me projekt-propozimin pranë Komisionit Evropian më anë të cilit propozim KNJ do të ishte bartës i projektit në ofrimin dhe sigurimin e ndihmës juridike për grupet e marginalizuara me anë të ofrimit të mjeteve efektive, efikase, gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe të qëndrueshme. Projekti në fjalë përfshin 4 aktivitete për realizim nga hapja e klinikave juridike; ndërmarrjen e fushatave gjithëpërfshirëse; trajnimi dhe avancimi profesional i personelit dhe aftësimin profesional të praktikantëve.
4. Duhet veçuar edhe pjesëmarrjen e Koordinatorës për ndihmë juridike në grupin punues qeveritar për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit kundër dhunës në familje të hartuar nën udhëheqjen e Qeverisë së Kosovës. Gjithashtu Koordinatorja e ndihmës juridike ka marrë pjesë edhe në debatin lidhur me zbatimin e ligjit për qasje ne dokumente zyrtare.
5. ZK ka pritur në zyrat e veta edhe anëtarët e OJQ-ve serbe që veprojnë në Kosovë për njoftimin e tyre me punën e KNJ dhe shërbimeve të ofruara për grupet e cënueshme në veçanti. Ky takim është aranzhuar në bashkëpunim të ngushtë me OJQ ‘Norma.’

Edukimi dhe ngritja e vetëdijes së publikut

Në përputhshmëri me mandatin e KNJ për edukimin dhe ngritjen e vetëdijes së publikut për sistemin e ndihmës juridike në Kosovë dhe shërbimet e ofruara nga ana e KNJ, ZK ka udhëhequr dhe realizuar prodhimin e emetimit të 3 video spoteve në 3 TV kanalet kyçe në Kosovë, Radion Televizionin Publik të Kosovës RTK, Radio Televizionin 21 dhe Koha Vision KTV. Emetimi mbi ndihmën juridike është emetuar në 3 gjuhë (shqip, serbisht dhe boshnjakisht.) Me këtë fushatë KNJ ka arritur të bën ngritjen e vetëdijes publike lidhur me të drejtat qe ofrohen në Kosovë me anë të sistemit të ndihmës juridike.



Personeli

Edhe gjatë vitit 2009, KNJ-ja ka vazhduar të vepron me strukturën organizative të paraparë në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/36 për ndihmë juridike. Në vitin 2009 KNJ ka hartuar dhe miratuar organogramin e ri të KNJ i cili do të zbatohet pas hyrjes së ligjit të ri për ndihmë juridike që pritet të hartohet gjatë vitit 2010.

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2009, ZK në veçanti është përcjellë me një sërë problemesh të reflektuara nga buxheti dhe numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve për ndihmë juridike. Në këtë periudhë janë bërë ndryshime të pakta në ngritjen e personelit të ndihmës juridike me rekrutimin e dy zyrtarëve për ndihmë juridike, një në Zyrën Koordinuese, dhe një në Byronë e Qarkut në regionin e Prishtinës. Është bërë edhe rekrutimi për pozitën e Asistentit Administrativ në BQNJ-Prishtinë.

Procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.MSHP/DASH 2003/01 mbi Procedurat e Rekrutimit në UA 2003/2 lidhur me zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës dhe Rregulloren 2001/36 mbi shërbimin civil të Kosovës.

Përkundër vështirësive KNJ gjatë vitit 2009 ka arritur të shton numrin e personelit për 15 zyrtarë të tjerë më përkrahjen e UNDP për realizimin e projektit ‘Qasja në Drejtësi’ me anë të hapjes së 5 zyreve të reja për ndihmë juridike. Gjithashtu janë rekrutuar edhe 6 zyrtarë për ndihmë juridike me anë të partneritetit me 2 OJQ-të. Më poshtë, paraqesim strukturën organizative të KNJ sipas Rregullores 2006/36.



Prtneritet i Knj-së me OJQ-të

<p>Podujevë</p> <p>SHJ “Norma” 2 Jurist 1 As. Administrativ</p>
--

<p>Gjakovë “Shoqata e Gruas Gjakovë” 2 Jurist 1 As Administrativ</p>

Trajnimet e personelit në vitin 2009

Duhet cek se vijueshmëria e trajnimeve nga ana e personelit të ndihmës juridike ka qenë në nivelin e kënaqshëm në veçanti në gjashtë-mujorin e parë të vitit 2009. Në këtë periudhë është ofruar mundësia për trajnime nga një sërë e organizatave dhe misioneve të huaja që veprojnë në Kosovë si dhe nga ana e institucioneve të Qeverisë së Kosovës sikurse Instituti i Administratës Publike i Kosovës (IKAP). Si problematike do të veçohej mosrealizimi i një pjesë të projektit të Komisionit Evropian të quajtur ‘Human Dynamics.’ Nga ky projekt nuk është realizuar komponenti i pestë i projektit lidhur me trajnimin e stafit të ndihmës juridike sipas obligimeve në projektin e cekur.

Në tabelën vijuese paraqesim trajnimet e realizuara për ngritjen e kapaciteteve profesionale të ZK-së:

Institucioni përkrahës	Tema e trajnimit
USAID- NCSC	Arsyetimi Ligjor
Zyra Amerikane	Hetimi dhe ndjekja e veprave penale të trafikimit me njerëz dhe veprave të ngjashme penale
Zyra Amerikane	Avokimi për viktime: Te drejtat dhe shërbimet për viktime. Trajnimi kosovar për viktimadëshmitar
IKAP	Menaxhimi i kualitetit të shërbimeve

IKAP	Vlerësimi i nevojave për trajnim
IKAP	Vlerësimi i nevojave për trajnim
MEF	BDMS dhe PIPi
UNDP	Punëtorja planifikuese për fuqizimin juridik, arsimimin juridike dhe ofrimin e ndihmës juridike ne Kosove: Përgatitja e një plani pers batimin e strategjisë ne kuadër te projektit te përkrahur nga UNDP për qasje ne drejtësi
MEF	Moduli i blerjeve

Gjatë vitit 2008 Zyra Koordinuese është përballur me një varg problemesh që kanë penguar funksionimin më efikas të saj. Ndër problemet kryesore ka qenë mungesa e mjeteve të domosdoshme buxhetore, gjë që ka ndikuar të mos punësohet numër i nevojshëm i zyrtarëve.

ZK ka angazhuar gjithë potencialin e vet në mbrojtjen e interesit të ligjshëm të kërkuësve, duke i realizuar programet e parapara për dhënien e ndihmës juridike falas dhe duke i koordinuar të gjitha aktivitetet e personelit të Ndhimës juridike. ZK ka marrë pjesë në takime të ndryshme, tryeza të rumbullakëta dhe konferenca dhe në takime me gazetarët e mediave të shkruara dhe elektronike, me qëllim të sensibilizimit, jo vetëm të institucioneve të Republikës së Kosovës, por edhe të organeve të tjera qeveritare dhe joqeveritare përpos opinionit të gjerë.

Buxheti

Buxheti i KNJ-së për vitin 2009 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, në shumën prej **265.197.00 €**. Vërehet një zvogëlim i buxhetit të KNJ për vitin 2009 në krahasim me buxhetin e ndarë nga Kuvendi i Kosovës për vitin 2008 i cili ishte në vlerë prej **275.672.00 €**.

Në bazë të kërkesës së Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, ZK ka bërë përgatitjen e rrjedhës së parave për vitin 2009, e cila në formë të shkruar i është dorëzuar MEF-it. Në këtë periudhë raportuese, ZK ka hartuar Planin afatmesëm tre-vjeçar të shpenzimeve për KNJ-në, i cili në formë të shkruar i është dorëzuar Departamentit për Buxhet në MEF.

ZK është angazhuar për kryerjen e të gjitha pagesave me afat dhe në mënyrë të rregullt, duke përfshirë pagesat e avokatëve për shërbimet juridike, pagesën e qirave për shfrytëzimin e objekteve, dhe pagesave të tjera të nevojshme për funksionimin e KNJ-së.

Gjatë kësaj periudhe për shërbime juridike të avokatëve janë shpenzuar **25,107.00 €**.

Vijat buxhetore	Shuma e buxhetit	Alokimi	Mjetet e shfrytëzuara	Zotimet e pashlyera	Mjetet e pashfrytëzuara	Progresi ndaj buxhetit në %	Struktura në %
Pagat dhe mëditjet	66,985.00 €	66,985.00 €	64,433.13 €	-	2,551.87 €	96.19 €	26.88 €
Mallrat dhe shërbimet	176,952.00€	176,952.00€	158,260.48 €	9,969.03 €	8,722.49 €	89.44 €	66.03 €
Shpenzimet komunale	21,260.00 €	21,260.00 €	16,986.60 €	24.11 €	4,249.29 €	79.90 €	7.09 €
Gjithsej	265,197.00€	265,197.00€	239,680.21 €	9,993.14 €	15,523.65 €	90.38 €	100.00 €

Nga shuma e tërësishme, KNJ-a, gjatë vitit 2009, ka realizuar **90.38 %** të mjeteve nga buxheti i miratuar apo gjithsej **239.680.21 €**.

Paraqitja e shpenzimeve për vitin 2009

Sa i përket buxhetit fillestar Komisionit për Ndihmë Juridike u janë lejuar 260,172.00 €. Me rishikimin e buxhetit të Kosovës për vitin 2009 janë shtuar edhe 5,025.00 €

Sa i përket shumës nga kategoria e pagave, e njëjta është realizuar 96.19%. Pjesa tjetër 3.81%, gjegjësisht shuma prej 2,551.87 € nuk është shpenzuar, për arsye se disa punonjës nga stafi i ND kanë ndërpre marrëdhënien e punës dhe paga e tyre ka mbetur e pa shfrytëzuar.

Shuma nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve është realizuar 89.44%, qe do të thotë, se kanë mbetur pa u realizuar 8,722.49 €. Kemi bërë kërkesë me kohë për riridestinimin e këtyre mjeteve mirëpo nuk është mundësuar nga ana e MEF-it. Duhet cekur se ZK është ballafaquar edhe me mungesën e personelit adekuat për financa meqë nga shtatori i vitit 2009 deri në fund të vitit 2009 ka munguar Zyrtari i Lartë për Financa (ZLF) meqë pozita ka qenë vakante.


Shuma nga kategoria e shpenzimeve komunale është realizuar 79.90%. Shuma në vlerë prej 4,273.40 €, ka mbetur e porealizuar, gjithashtu për arsye të mungesës së ZLF.

Nga kjo rrjedhë se nga buxheti i KNJ-së suficit ka mbetur shuma prej 15,523.65 €. Duke marrë parasysh menaxhimin e buxhetit për vitin 2009 paraqesim interpretimin e shpenzimeve sipas periudhave periodike:

Vijat	Janar-	Prill-	Korrik-	Tetor-	Gjithsej
-------	--------	--------	---------	--------	----------

buxhetore	Mars	Qershor	Shtator	Dhjetor	
Pagat	14,968.31 €	16,105.74 €	17,964.24 €	15,394.84 €	64,433.13 €
Mallrat dhe shërbimet	11,041.12 €	47,550.46 €	32,758.22 €	66,910.68 €	158,260.48€
Shpenzimet komunale	2,286.91 €	6,869.44 €	6,297.80 €	1,532.45 €	16,986.60 €
Gjithsej:	28,296.34 €	70,525.64 €	57,020.26 €	83,837.97€	239,680.21 €

Paraqitja grafike e shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2009:



Prokurimi

Është dorëzuar raporti vjetor i punës për kontratat e nënshkruara publike i cili është dorëzuar Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) të Kosovës, e i cili ka të bëjë me 16 lëndë të prokuruar të autoritetit kontraktues KNJ.

Zyra e Prokurimit pranë KNJ-së gjatë vitit fiskal 2009 ka zhvilluar gjithsej procedura të prokurimit publik. Prej tyre 6 kanë qenë me kuotim të çmimit me vlerë minimale prej 100,00 € deri në 1,000,00 €.

Në vijim paraqitet lista e **kuotimit të çmimit me vlerë minimale:**

1. Sigurimi i auto veturave të KNJ.
2. Larja e auto veturave të KNJ.
3. Sistemi alarmues i KNJ
4. Furnizimi me dispanzer për ujë të pijes për KNJ.
5. Furnizimi me ujë të pijes për KNJ.
6. Furnizimi me material shpenzues higjienik për KNJ.

Gjithashtu janë realizuar 10 procedura të prokurimit publik me kuotim të çmimit me vlerë të vogël prej 1.000,00 € deri në 10,000,00 €.

Në vijim paraqitet lista e kuotimit ***të çmimit me vlerë të vogël:***

1. Shërbimet e përkthimeve të KNJ,
2. Klimatizimi i BQNJ-ve në Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan.
3. Mirëmbajtja e higjienës të zyreve të KNJ.
4. Furnizimi me karburantë për nevojat e KNJ.
5. Kursi i gjuhës angleze për punëtorët e KNJ.
6. Furnizimi me material harxhues të zyrave për nevojat e KNJ

Gjatë vitit 2009 janë bërë 8 vazhdime të kontratave nga procedurat e prokurimit të kontratave ekzistuese. Këto janë:

1. Servisimi dhe mirëmbajtja e TI-ve për nevojat e KNJ-së.
2. Furnizimi me mobile për nevojat e KNJ-së në vlerë prej
3. Servisimi i autovegurave për nevojat e KNJ-së.
4. Sigurimi fizik i objektit të KNJ-së.
5. Shërbimi i shtypjes së notesave dhe kalendarëve për nevojat e KNJ-së.
6. Emetimi i spotit televiziv për nevojat e KNJ-së.
7. Vazhdimi i kontratave për qira të BQNJ-ve në Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan

Për lëndët e prokuruar janë zhvilluar procedurat e rregullta të prokurimit në pajtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në Kosovë. Gjithmonë është zbatuar procedura standarde për marrjen e ofertave nga ofertuesit, formimin e komisioneve për hapjen dhe vlerësimin e tyre dhe lidhjen e kontratave me operatorët ekonomikë që janë përzgjedhur.

V. BYROTË E QARKUT PËR NDIHMË JURIDIKE (BQNJ)

Aktualisht ofrimi i ndihmës juridike shtrihet në tërë territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet byrove të qarkut për ndihme juridike në 5 regjione të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan. Në BQNJ-të, në mënyrë të drejtpërdrejtë, çdo qytetari me gjendje të vështirë materiale, që i plotëson kriteret e përcaktuara në Rregulloren 2006/36, i ofrohet ndihmë juridike në lëmin e çështjeve civile, administrative dhe penale.

Të gjitha byrotë e qarkut janë të vendosura në objekte private, me qira. Tani së fundi si rezultat i punës dhe bashkëpunimit të KNJ me Kryetarët e Komunave të Gjakovës, Dragashit, Ferizajit dhe pjesës veriore të Mitrovicës janë hapur tre zyre

për ndihmë juridike për të cilat nuk paguhet qiraja, nga projekti i UNDP-së ‘Qasja në Drejtësi.’ Në komunën e Graçanicës vazhdohet të paguhet qiraja.


Përveç BQNJ-së në Prishtinë dhe Zyrës Koordinuese në Prishtinë, asnjë BQNJ tjetër nuk ka në dispozicion veturë zyrtare, gjë që e pengon formimin e klinikave juridike në komuna tjera në të cilat qytetarëve do t’u ofrohej ndihmë juridike falas ditëve të caktuara në javë. KNJ i është drejtuar disa herë radhazi qeverisë për një përkrahje shtesë për vetura edhe për BQNJ-të tjera.

Veprimtaria e BQNJ-ve për Ndhimë juridike:

BQNJ-të në përputhje me Rregulloren 2006/26 kanë disa fushëveprime sikurse: a) Pranimi i kërkesave për ndihmë juridike; b) Sjelljen e vendimit nëse kërkuesi ka të drejtë të bëhet përfitues i ndihmës juridike; c) Sjelljen e vendimit nëse kërkuesi ka të drejtë në ndihmë juridike primare apo sekondare, gjë që varet nga gjendja e tij financiare; d) Duke u nisur nga kërkesa e parashtruesit, sigurojnë ofrimin e ndihmës juridike në përputhje me vendimin dhe varësisht nga rasti, e drejtojnë kërkuenin tek ofruesi i drejtpërdrejtë i ndihmës juridike sikurse avokatët e kërkuar, avokatët e kontraktuar, klinikat e ndihmës juridike, OJQ-të në partneritet dhe programet studentore. Në vijim, paraqesim pasqyrën e lëndëve të ndihmës juridike të ofruara nga BQNJ-të për vitin 2009 në lëmi të ndryshme. Tabelat pasqyrojnë numrin e lëndëve sipas kërkesave. Për shumicën e lëndëve janë ndërmarrë deri në 5 (pesë) veprime juridike.^{ix}

Lëmi civile


Nga grafikoni që vijon, është dhënë gjendja faktike e kërkuessve të ndihmës juridike falas, nga shihet se në 92 % në procedurën kontestimore (familjare, pronësoro juridike, detyrimore etj.), dhe 8 %, në procedurën jashtëkontestimore (shqyrtimi i trashëgimisë, ndarja fizike, shpallja e personit të zhdukur si të vdekur, rregullimi mezhdës, etj).



Pasqyrë e rasteve të procedurës civile

Veprimet juridike në lëmin civile janë ndërmarra në përpilimin e shkresave me 44% , me këshilla juridike 26% dhe lëndë të referuara te avokati në 30 % .


Pasqyrë:



Lëmi administrative

Nga grafikoni që vijon, është dhënë gjendja faktike e kërkuesve të ndihmës juridike falas, nga shihet se në 66% të rasteve u është ofruar ndihmë juridike për çështje sociale (fitimi i të drejtës për shfrytëzimin e ndihmës sociale, lidhjen e kontratave për shkëputje nga bashkësia familjare, etj); kurse 14 % , në çështje pensionale (pensioni i pleqërisë, pensioni invalidor, pensioni për personat me aftësi të kufizuara, etj). Në 20 % ndihma juridike është ofruar në çështje të tjera administrative.

Pasqyrë:




Lëmi penale

Për shkak të mosgatishmërisë së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KNJ-ja nuk ka arritur marrëveshje mirëkuptimi për bartjen e buxhetit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në KNJ për ofrimin e ndihmës në çështjet penale, përkatësisht për rastet e caktimit të avokatëve ex officio. Kjo ka vazhduar të pengon edhe në vitin 2009 angazhimin e avokatëve për këto çështje. Për këtë arsye BQNJ-të kanë ofruar ndihmë juridike në çështje penale, vetëm duke dhënë këshilla juridike dhe ndihmuar në përpilimin e shkresave.

Në lëmin penale, në 61 % është ofruar ndihma juridike për vepra penale (kallëzim penal, këshilla juridike, ankesa, etj.), në 35 %, është ofruar ndihma juridike lidhur me procedurën e shkurtër (kundërshtimi kundër urdhrin ndëshkëimor, vërejtjes gjyqësore, etj), dhe 4 % kanë qenë të tjera nga lëmia penale.

Pasqyrë:



VI. BASHKËPUNIMI I KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE ME ODËN E AVOKATËVE (OAK)

Në përputhje me Rregulloren 2006/36 (Neni 7.1), KNJ bashkëpunon me Odën e Avokatëve të Kosovës në përcaktimin e masave pozitive për të siguruar përfaqësim të drejtë të përfituesve ashtu edhe të ofruesve të ndihmës juridike.

KNJ vazhdon të bashkëpunojë me OAK në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të lidhur në mes të OAK dhe KNJ në vitin 2008 për bashkëpunim me qëllim të angazhimit të avokatëve, në raste kur përfituesit e ndihmës juridike duhet të përfaqësohen në procese gjyqësore.

Marrëveshja e mirëkuptimit përcakton obligimin e OAK-së, që çdo 3 (tre) muaj, për KNJ-në, të azhurnojë listat e avokatëve të gatshëm që të përfaqësojnë përfituesit e ndihmës juridike.

Në periudhën raportuese për vitin 2009, janë angazhuar 404 avokat.

VII. BASHKËPUNIMI I KOMISIONIT PËR NDIHMË JURIDIKE ME OJQ-të NË PARTNERITET

Me nenin 8 të Rregullores 2006/36, është paraparë që Komisioni i Ndhimës Juridike mund të hyjë në partneritet me OJQ-të, me qëllim që t'u ofrojë ndihmë juridike grupeve të cenuara brenda zonave të përkufizuara gjeografike, apo atyre me kompetenca të veçanta.

Gjatë vitit 2009 KNJ ka hyrë në partneritet me 2 OJQ, Shoqatën e juristeve "NORMA" për hapjen e zyrës për ndihmë juridike në Podujevë dhe me "Shoqatën e Gruas" Gjakovë për funksionalizimin e zyrës së ndihmës juridike në Gjakovë. Të dy OJQ-ve iu është ndarë shuma prej 5,000.00 Euro për realizimin e ndihmës juridike.

VIII. BURIMET FINANCIARE DHE NIVELI I FINANCIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Meqenëse KNJ është institucion i pavarur, shtetëror, çështja e financimit është rregulluar me Rregulloren 2006/36 (Neni 4.14) ku përcaktohet se mjetet financiare për buxhetin e KNJ-së sigurohen çdo vit nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe planin e buxhetit të paraqitur nga KNJ, e miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në pajtim me pikën 4.15 (k) të Rregullores 2006/36, kompetencat dhe përgjegjësitë e KNJ-së përfshijnë planifikimin e buxhetit për ndihmë juridike dhe sigurimin e mjeteve financiare nga donatorët, qeveria dhe autoritetet tjera buxhetore.

Vlen të ceket se për KNJ-në, inkurajuese ka qenë pranimi i qarkores së parë të buxhetit për vitin 2010 nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, e cila shënoj një rritje në shumë prej 30.000 € për Projekte Kapitale, dhe shumë prej 6.504 € për mallra dhe shërbime.

Për vitin 2009 nga Kuvendi i Kosovës për ndihmën juridike janë ndarë mjetet në shumë prej **265.197.00 €**.

BUXHETI NË VIJA TË TRASHA		SHUMA
1.	Paga dhe mëditje në shumë prej	66.985.00 €
2.	Mallra dhe shërbime në shumë prej	176.952.00 €

3.	Shpenzime komunale në shumë prej	21.260.00 €
----	----------------------------------	-------------

IX. MANGËSITË DHE SFIDAT NË SISTEMIN E NDIHMËS JURIDIKE

Fondet për funksionimin e KNJ-së sigurohen nga Buxheti i Kosovës. Mirëpo, deri më tani, KNJ vazhdon të sfidohet nga një sërë problemesh për mungesë të sasisë së nevojshme të mjeteve financiare, që janë të domosdoshme për funksionimin e rregullt të KNJ-së dhe për ruajtjen e pavarësisë së këtij institucioni me rëndësi të veçantë. Edhe pse në vitin 2009 KNJ ka arritur të shënojë hapje të zyrave të reja dhe rritjen e numrit të personelit me përkrahje të donatorit UNDP, pritet një involvim dhe përkrahje më serioze nga ana e institucioneve qeveritare. Në këtë drejtim, KNJ ka përlogaritur shpenzimet e veta reale për një funksionim të mirëfilltë dhe ka hartuar Planin afat-mesëm tre-vjeçar të shpenzimeve për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Mangësitë e mëposhtme mbesin sfidë e vazhdueshme e KNJ-së për zbatimin e mandatit të vet në përputhje me ligjin:

Numri i vogël dhe i pamjaftueshëm i personelit - Numri i vogël i zyrtarëve dhe pamundësia e kompletimit të personelit është pasojë e buxhetit të limituar, gjë që ka qenë dhe mbetet problem thelbësor në përmbushjen e plotë të misionit të këtij institucionit. Mungesa e zyrtarëve ndikon shpesh edhe në afatin e kryerjes së punëve.

Pagat - Niveli i pagave të personelit në KNJ është jostimulues dhe aspak motivues për ekspertë të kësaj fushe. Personeli i këtij institucioni të rëndësishëm duhet të stimulohet dhe, patjetër, duhet bërë kategorizimi i pozitave me rëndësi të veçanta.

Rreziku nga largimi eventual i personelit ekzistues – Për shkak të të ardhurave të pakta personale në KNJ, jo vetëm që s’ ka gjasa të kompletohet ai personel i nevojshëm, por ka rrezik të largohen edhe zyrtarët e tanishëm, për ngritjen profesionale të të cilëve KNJ-a ka mobilizuar të gjitha mundësitë që i ka pasur. Largimi eventual i zyrtarëve që janë të inkuadruar drejtpërsëdrejti në të gjitha proceset e punës së ndihmës juridike, do të rrezikonte funksionimin e KNJ-së në tërësi.

Buxheti - Në tre vitet që lamë pas, MEF-i nuk e ka miratuar kërkesën e KNJ për mjete buxhetore për paga dhe mëditje. Mungesa e mjeteve buxhetore ka bërë që KNJ-a të ballafaqohet me pengesa dhe vështirësi në funksionimin e suksesshëm të tij.

Mungesa e mjeteve materiale – Rregullorja 2006/36 parasheh krijimin e klinikave juridike nëpër komuna tjera të Republikës së Kosovës. Duke u nisur nga fakti se një regjion mbulon më shumë komuna, përfituesit e ndihmës juridike falas kanë vështirësi, si subjektive ashtu edhe objektive për realizimin e të drejtave të tyre, për arsye se byrotë e qarkut janë në një distancë gjeografike të madhe. Formimi i klinikave juridike është i domosdoshëm. Në mungesë të mjeteve materiale për blerjen e veturave, KNJ nuk ka arritur që nëpërmjet klinikave juridike, qytetarëve të komunave të ndryshme, t’u ofroj shërbimet e ndihmës juridike.

Byrotë e qarkut për ndihmë juridike – Janë të vendosura në objekte private dhe nuk garantojnë shfrytëzim për periudha të gjatë kohore. Pronarët e tyre shpesh kërkojnë t’u lirohen ato objekte për arsye të ndryshme.

X. REKOMANDIMET

1. Hartimi **Ligji për Ndhmë Juridike Falas** mbetet prioritet për vitin 2010. Përvoja e deritashme ka treguar se Rregullorja 2006/36 nuk i përfshin të gjitha çështjet me rëndësi për ndihmë juridike. Përveç kësaj, kjo Rregullore është e tejkuluar për vetë faktin se ajo nuk është e harmonizuar me legjislacionin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu pas hyrjes në fuqi të ligjit në fjalë KNJ do të kishte mundësi të reflektonte në mënyrë më substanciale nevojat e veta si dhe të kërkonte edhe zbatimin e organogramit të ri të hartuar dhe miratuar nga KNJ gjatë vitit 2009.
2. Sensibilizimi i vazhdueshëm i institucioneve dhe organeve të Republikës së Kosovës për rëndësinë që duhet kushtuar këtij institucioni dhe edukimit në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për rolin dhe mundësitë që u ofron KNJ.
3. Ngritja e mëtejme profesionale e stafit të këtij institucioni për shfrytëzimin e të gjithë mekanizmave ekzistues ligjor për ndihmë juridike, është e nevojshme.
4. Hartimi i Planit afatmesëm tre-vjeçar (planifikimi i shpenzimeve me rritjet të kërkuara nga ana e MEF-it), për funksionimin e mirëfilltë të KNJ-së.
5. Arritja e objektivave të qarta të KNJ dhe tejkalimin e sfidave edhe gjatë vitit 2010, duke vazhduar angazhimin maksimal në mënyrë aktive, në krijimin e parakushteve konkrete dhe praktike si pjesë e integritetit të sistemit të ndihmës juridike, në mënyrë që shërbimet e ofrimit të ndihmës juridike të jenë sa më të efektshme, efikase, gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe të qëndrueshme.

ANEKS

Tabela statistikore për lëndët e Ndhmës Juridike në 5 BQNJ-të, gjatë vitit 2009

ⁱ Neni 3 pika (u) të Rregullores për Ndhmë Juridike 2006/36

ⁱⁱ Neni 3, alineja (u); Rregullorja e UNMIK-ut 2006/36.

ⁱⁱⁱ Kodi Penal i Kosovës, i ndryshuar nga Kuvendi i Kosovës 2008.

^{iv} Rregullorja 2006/36 ka hyrë në fuqi me 7 qershor 2006 pas nënshkrimit nga ana e Përfaqësuesit Special të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

^v Marrë nga Neni 4,

^{vi} Neni 4.2. dhe 4.4. të Rregullores për Ndhmë Juridike

^{vii} Neni 4.15. pika (t) e Rregullores 2006/36 së UNMIK-ut për ndhmë juridike.

^{viii} Neni 5.

^{ix} Neni 6 të Rregullores për Ndhmë juridike